



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Datë: 11.06.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Nr.020-490/3 Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin Nr. 12-030-22702 për lirimin nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë-periferike dhe nder urbanë që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Trim Berisha , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Hekuran Murati , Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora , Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Engjëllusha Januzi , Zyrtare e Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
I ëndër:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit
I loji i aktit:	Vendim

I nderuari Ministër z. Krasniqi,
I nderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha.

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, Departamenti

Ligjori i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendimi Nr. 12-030-22702 për lirimin nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbane-periferike dhe ndër-urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Drenas</i>
<i>I miratuar më datë 31.05.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.06.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.06.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit përmbajtësor të aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

- Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon lirimin nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik në këtë komunë.

Për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se inkasimi i të hyrave që vijnë nga kjo pagesë realizohet përmes *ndërmarrjes publike lokale* "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në komunën e Drenasit.

Në këtë drejtim, neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (këtej e tutje referuar si "Ligji"), i njej të hyrat që derivojnë nga ndërmarrjet publike si kategori e të hyrave vetanake të organizatës buxhetore.

Rrjedhimisht, meqenëse të hyrat në rastin konkret konsiderohen burime financiare komunale, komuna *disponon lirshëm me to* dhe ka *pavarësi financiare* gjatë ushtrimit të kompetencave të saj komunale, sikurse përcaktohet me nenin 2, paragrafin 3 të Ligjit.

- Me relevancë për shtjellimin e këtij vlerësimi, masa e përcaktuar në vendimin e komunës ndikon në reduktimin e të ardhurave të komunës. Si rezultat, akti komunal i plotëson kriteret për t'iu nënshtruar rregullave të ndihmës shtetërore, të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore (këtej e tutje referuar si "LNSH"). marrë për bazë se ky i fundit potencon që ndihmë shtetërore konsiderohet edhe çdo reduktim i të ardhurave të shtetit.

Në përmbajtje të aktit administrativ nuk është e specifikuar vlera e pagesës së peronizimit, mirëpo konform konsultimeve të Komunës së Drenasit me strukturat përgjegjëse të Ministrisë, vlerësohet se kemi të bëjmë me përfitim në vlerë të vogël, që nuk e tejkalon shumë prej 200,000 EUR (për 3 vite fiskale), për secilën kompani përfutuese. Nisur mbi këtë bazë, Komuna e Drenasit duhet të respektojë:

- Nenin 7: Ndihma "De Minimis" të LNSH, nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale), dhe kështu sipas Nenit 19 të Rregullores

(QRK) Nr. 04/2020 për Ndihmën "De Minimis", institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njoftimit, konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores në Departamentin e Ndihmës Shtetërore në Ministri.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, akti administrativ i Komunës së Drenasit nuk është në kundërshtim me dispozitat në fuqi – me kusht që sqarimet e theksuara në këtë shkresë të merren parasysh nga Komuna gjatë procedimit të mëtejshëm.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Kuvendi i Komunës



Nr. 12.030-22702 dt. 31.05 2021

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.031/L-040 , nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Rregullores nr. 12.030-19516 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha dhe kërkesës se Shoqatës se Transportit Publik të udhëtareve me Autobus, më dt. 28.05.2021 nr. 13-070-22179, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.05.2021, miratoi këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtareve me autobus për linjat urbanë-periferike dhe nder urbanë që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.

Neni 1

Me këtë Vendim, kërkohet lirimi nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtareve me autobus për linjat urbanë-periferike dhe nderurbanë që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc për operim.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e peronizimit, është në afatin kohor prej 6 muajsh, nga miratimi i këtij Propozim –Vendimi, me mundësi vazhdimi , varësisht prej gjendjes se krijuar Pandemisë nga COVID-19.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj